



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 211, Datë 17.08.2022

MBI

SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR
APLIKIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pikat 2 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/3 prot., datë 12.08.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 24.05.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gostima 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, “Gostima 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW, “Gostima 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW, “Gostima 4” me kapacitet të instaluar 7396 kW, “Gostima 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW, “Gostima 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW dhe “Gostima 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW, me kapacitet total të instaluar 48 864 kW.
- ERE ka bërë njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 25.05.2022 dhe 26.05.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme nga të tretët (data 05.07.2022) nuk ka rezultuar të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 636/1 prot., datë 06.06.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin dhe kërkesën për plotësim dokumentacioni.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 636/5, datë 12.07.2022 dhe nr. 636/7 prot., datë 05.08.2022, ka përcjellë dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se mbetet ende pa u plotësuar sa vijon:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor neni 9, pika 2:

- **gërma “g”** ; Në lidhje me kërkesat e kësaj pike të rregullores, shoqëria ka depozituar kontratat përkatëse të qirasë për zonën ku do të zhvillohet projekti, ku afati i hyrjes në fuqi të secilës prej këtyre kontratave kushtëzohet nga marrja e lejes së ndërtimit. Gjithashtu, fillimi i punimeve të ndërtimit të veprës vlejné dhe për të përlllogaritur afatin e vlefshmërisë së Deklaratës Mjedisore, datë 27.08.2020, lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit, për Personin Juridik “Egnatia Hydropower” sh.p.k., për të zhvilluar projektin e zbatimit të HEC-eve “Kaskada Egnatia-Shushicë”. **Sa më sipër shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e ndërtimit dhe informacion mbi fillimin e punimeve.**

Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3

- **gërma “c”** ; Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion/informacion argumentues mbi strukturën dhe mënyrën e financimit të 40% të vlerës së investimit të projektit.

Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1

Në lidhje me kërkesat e rregullores, shoqëria duhet të plotësojë për secilin nga HEC-et të dhënat në lidhje me Kapacitetin ujëmbledhës, Nën/stacionin ku lidhet, Rendimentin dhe Jetëgjatësinë e pritshme të centralit.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, është parashikuar se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.*
- Shoqëria ka plotësuar pjesën më të madhe të dokumentacionit të kërkuar nga rregullorja, për këtë arsye vlerësohet shtyrja me 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit të vendimmartjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë për të plotësuar dhe dokumentacionin/informacionin e mbetur të pa plotësuar tërësisht.
- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin/informacionin përkatës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e vendimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e vendimit, shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE:
 - a) lejen e ndërtimit dhe informacion mbi fillimin e punimeve;
 - b) dokumentacion/informacion argumentues mbi strukturën dhe mënyrën e financimit të 40% të vlerës së investimit të projektit;
 - c) informacion mbi kapacitetin ujëmbledhës, nën/stacionin ku lidhet, rendimentin dhe jetëgjatësinë e pritshme e centralit, për secilin nga HEC-et, sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 4.1.1.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI